

NJOHJA ME KODIN E IESBA-së


Pjesa 2: Kuadri Konceptual- Hapi 1, Identifikimi i Kërcënimeve



Profesionistët kontabël kanë përgjegjësi për të vepruar gjithmonë në interes të publikut. Pajtueshmëria me parimet themelore ndihmon në ruajtjen e këtyre përgjegjësive. Megjithatë, ndonjëherë rrethanat në të cilat operon një profesionist kontabël në punën e tij të përditshme mund të krijojnë pengesa ose "kërcënime" në aftësinë e këtij profesionisti kontabël për të vepruar në pajtueshmëri me parimet themelore.

Çfarë është Kuadri Konceptual?

Kuadri konceptual është një qasje që kërkohet të zbatohet nga të gjithë profesionistët kontabël për të vepruar në pajtueshmëri me parimet themelore. Ai përfshin identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve. Në këtë mënyrë, profesionistëve kontabël u kërkohet të ushtrorjnë gjykim profesional; të jenë vigjilentë ndaj informacioneve të reja dhe ndryshimeve në faktet dhe rrethanat; dhe të përdorin testin e palëve të treta të arsyeshme dhe të besueshme.



Audituesve u kërkohet të jenë të pavarur kur kryejnë auditime, rishikime dhe angazhime të tjera të sigurisë. Në këtë mënyrë, atyre u kërkohet gjithashtu të zbatojnë kuadrin konceptual për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet për pavarësinë.

ÇFARË JANË KËRCËNIMET?

Kërcënimet ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore kategorizohen si:
Interesi vetjak | Vetë-rishikimi | Favorizimi (Përkrahja) | Familjariteti | Frikësimi

Le t'i vendosim këto kërcënime në kontekst dhe të zbatojmë kuadrin konceptual për të identifikuar kërcënimet e pajtueshmërisë me parimet themelore. Për ta bërë këtë, le të rishikojmë rolin (nga pjesa 1) e Drejtuesit të Politikës Kontabël, i cili punon për një kompani ndërkombëtare prodhuese.

CEO ka një plan për të nisur veprimtarinë në një treg në zhvillim. Si Drejtues i Politikës Kontabël, ju nuk jeni të sigurtë që plani është në pajtueshmëri me ligjet për korrupsionin dhe ryshfetet.

Kompania së fundmi ka humbur pjesën e tregut dhe aksionet kanë humbur 10% të vlerës së tyre të tregut. Nëse të fitimet nuk përmirësohen sëshpejti, pushimet nga puna janë të pashmangshme - me shkurtimet që synojnë funksionet mbështetëse si ekipi juaj.

Një plan i ri i besueshëm për hyrjen në një treg me një marzh fitimi të lartë do të kënaqë Bordin e Drejtuesve dhe aksionerët. CEO gjithashtu ka premtuar shpërblime të konsiderueshme nëse ekipi do të "kryejë punën, me çdo kusht".

Ju keni rishikuar komunikimet me email - disa prej të cilave tregojnë se mjetet monetare janë transferuar në llogaritë bankare të vendeve të synuara rreth së njëjtës kohë që plani i ri i biznesit ishte duke u hartuar. Dokumentacioni mbështetës i pagesave nuk është i qartë, por ka pasur një numër "shpenzimesh kërkim-zhvillimi të biznesit" që i janë paguar ekspertëve gjatë fazës së planifikimit.

Në praktikë, profesionistët kontabël bëjnë pyetjet e mëposhtme në lidhje me secilën kategori të kërcënimit.

1 EGOIZMI (INTERESI VETJAK) — Çfarë është për mua dhe a ndikon kjo në vendimmarrjen time?

- ✓ A ju bën premtimi për një shpërblim të madh të hezitoni për të investiguar emailt që janë zbuluar? A ju bën më pak objektiv?

2 VETË-RISHIKIMI — A po e rishikoj punën time ose po vlerësoj rekomandimet e bëra më parë?

- ✓ A ishit të përfshirë në hartimin e planit, dhe nëse po, a do të kërcënonite kjo objektivitetin në vlerësimin e vijmësisë së planit?

3 FAVORIZIMI (PËRKRAHJA) — A jam unë i rrezikuar në promovimin e pozicionit të klientit ose punëdhënësit tim në mënyrë të papërshtatshme?

- ✓ E thënë ndryshe, a jeni në rrezik të tejkalimit të ligjit ose të vlerës së pozicionit / planit të CEO-s, pavarësisht shqetësimeve për çështjen e ryshfetit në mënyrë që të promovoni interesat e kompanisë?

4 FAMILJARITETI - A e kërcënon marrëdhënia ime afagjatë me klientin ose punëdhënësin vendimmarrjen apo gjykimin tim?

- ✓ A jeni i motivuar që të pajtoheni me planin e CEO-s, në vend që të ushtroni objektivisht gjykimin profesional, të pandikuar nga besimit tek CEO dhe nga procesi i vendimmarrjes së kompanisë?

5 FRIKËSIMI — A ndihem i kërcënuar në çfarëdo mënyre lidhur me kryerjen e punës sime në mënyrën e duhur, profesionale ose objektive?

- ✓ A ju shtyn qasja "me çdo kusht" e CEO-s drejt mendimit që puna dhe reputacioni janë në linjë nëse diçka ngadalësohet ose hyrja në tregun e ri nuk realizohet?



Konteksti është i rëndësishëm. Si pjesë e identifikimit të kërcënimeve, profesionistëve kontabël u kërkohet të kuptojnë faktet dhe rrethanat specifike, përfshirë ndonjë aktivitet profesional, interesa dhe marrëdhënie që mund rrezikojnë pajtueshmërinë me parimet themelore.

Në pjesën tjetër të kësaj Serie, ne do të tërheqim vëmendjen për të vlerësuar nëse kërcënimet e identifikuara janë në një nivel të pranueshëm. Do të përqendrohemi edhe në përdorimin e testit të një pale të tretë të arsyeshme dhe të besueshme.

KU MUND TË GJENDET INFORMACIONI I NEVOJSHËM?



Kuadri konceptual është paraqitur në Pjesën 1, Seksioni 120 i Kodit. Dispozitat shtesë që janë të rëndësishme për zbatimin e këtij kuadri janë paraqitur në Pjesët 2, 3, 4A dhe 4B, respektivisht Seksionet 200, 300, 400 dhe 900.



E-Code, i cili është i disponueshëm në www.IESBAeCode.org, është një burim online për profesionistët kontabël dhe përdoruesit e tjerë të Kodit.

“Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 2: Kuadri Konceptual- Hapi 1, Identifikimi i Kërcënimeve”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Janar 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 2: Kuadri Konceptual- Hapi 1, Identifikimi i Kërcënimeve” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 2: Kuadri Konceptual- Hapi 1, Identifikimi i Kërcënimeve” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Exploring the IESBA Code Installment 2 – The Conceptual Framework , Step 1, Identifying Threats”

Kontakttoni Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.